



Emri:	Blerta Dibrani
Organizata:	Komiteti Paralimpik i Kosovës
Email:	dibraniblerta1@gmail.com

Biografia e shkurtër:

Blerta Dibrani është asistente lëndore në Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës, si dhe kandidate për doktoratë në Universitetin e Ljubljanes. Ajo ka rreth 12 vite përvojë profesionale në mësimdhënie, hulumtim, marrëdhënie me publikun, gazetari dhe menaxhim të mediave sociale.

Në Departamentin e Gazetarisë, ajo ligjeron lëndë që lidhen me edukimin medial, mediat e reja, komunikimin strategjik dhe historinë e gazetarisë, ndërsa prej vitit 2024 shërben edhe si sekretare e këtij departamenti. Më parë ka punuar si zyrtare për media, asistente e Rektorit dhe zyrtare për marrëdhënie me publikun në Universitetin e Prishtinës, si dhe në vitin 2022 ka udhëhequr Departamentin e Komunikimit në FISU University World Cup Handball. Ka qenë gjithashtu autore dhe prezantuese e emisionit “Fakte Biznesi”, në TËVË1.

Ajo ka marrë pjesë në programe ndërkombëtare, trajnime profesionale dhe konferenca shkencore, me interesa kërkimore në komunikimin strategjik, marrëdhëniet me publikun dhe edukimin medial. Flet shqip, anglisht dhe ka njohuri bazike të gjuhës spanjolle.